Mjediset shumë të nxehta: energjia e ngrohte që hyn në trup është më e madhe se energjia që trupi shpenzon dhe sistemi i kontrollit të temperaturës nuk është në gjendje të ruaj temperaturën e brendshme në 37°C (rrezik gjendje të fikti ...)

Mjedise shumë të ftohtë: energjia e ngrohte që hyn në trup është më e vogël se energjia që trupi shpenzon dhe sistemi i kontrollit të temperaturës nuk është në gjendje të ruaj temperaturën e brendshme në 37°C (rrezik nga ngrirja ...)

MIKROKLIMA E NGROHTE

Rreziqet nga të nxehtit: simptomat

Lodhje, dhimbje koke, te vjellja, dhimbje të muskujve, humbja e përqendrimit, marramendje.

- Nëse jeni brenda një ndërtese, në rast se ben shume nxeht, hapni dritaret dhe dyert, por mos u vini perballe rrymave të ajrit.
- Në praninë të kondicionatorve apo ventilatorve, përdorini duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi.
- Veshuni me rroba pambuku që lehtësojnë shkëmbimin e nxehtësisë dhe te avullimit të djerses
- Kur jeni ne ambjent te hapur veshni një kapele për të mbrojtur kokën, qafën, fytyrën dhe veshët nga ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell.
- Përdorni, nëse është e nevojshme, një shami te lagur per ballin dhe qafën.
- Pushoni nën hije.
- Pini gllenka të vogla uji (jo të ftohtë), me intervale të rregullta.
- Nëse eshte e mundshme, nderrohuni, në detyrat më të renda, me kolegët e tjerë.

E rëndësishme : Sigurohuni që te keni me vete gjithmonë uje të pijshëm të mjaftueshëm !!!




EKSPOZIMI NDAJ RREZATIMIT DIELLORE

Ekspozimi ndaj rrezeve ultravjole te diellit mund të çojë në zhvillimin e **kancerit të lëkurës**. Rreziku rritet nga ekspozimi i zgjatur.

Mund të bëheni të vetëdijshëm për ekspozimin e tepërt kur fillojnë të shfaqen problemet e para të lëkurës, shenja te bardha ne krahe, ne fytyrë, ne hundë dhe ne veshët.

Tek sytë mund të zhvillohet katarakta (mjegullim i lentes së syrit)



- Në ditët me diell, veshni një kapele për të mbrojtur kokën, qafën, fytyrën dhe veshët nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ne diell.
- Vishni bluza me qafe te rrembullaket dhe me mëngë të gjata, material pambuku të lehta.
- Përdorni një krem mbrojetes kunder djellit, me faktor mbrojetes te larte, mbroni në veçanti, hunden, buzët, veshët, kokën, qafën dhe kurrizin e duarve.
- Lyhuni shpesh me krem, sidomos kur djersisni shume.
- Punoni sa më shumë që të jetë e mundur në hije, sidomos në orët më te nxehta te dites (nga ora 10 deri 16).
- Mbroni sytë duke përdorur syze dielli me lente kunder thyerjes.
- Pushoni në hije.
- Pini gllenka të vogla uji (jo të ftohtë), me intervale të rregullta.
- Nëse eshte e mundshme, nderrohuni, në detyrat më të renda, me kolegët e tjerë



MIKROKLIMA E FTOHTE



**RREZIK NGRIRJERE NGA TE
FTOHTET (RREZIK VDEKJE) !!!**



ENF 342

Rrezik nga te ftohtet:

- Ngrirje e pjesëve të trupit
- Morthi i te ftohtit



**Veshni rroba mbrojtëse (DPI) para se të
ekspozoheni ne të ftohtë !!!**



mammothworkwear.com



PROGETTO "PUNTO INFORMATIVO CAMPO SICURO"



AGRI – SOLUTION:

Guida pratica per l'informazione dei rischi
specifici dell'agricoltura dedicato al
personale straniero operante nell'azienda
agricola

"RISCHI CHIMICI"

ALBANESE

In collaborazione con:

Reziqet kimike

PESTICIDET

Ekspozimi ndaj pesticideve mund të shkaktojë, pavarësisht nga klase e rrezikut, dhe mund të jete:

helmim akut: kur trupi është i ekspozuar ndaj sasive masive të produktit në një kohë të shkurtër

helmim kronik: Organizmi është i ekspozuar ndaj sasive të vogla të produktit për një periudhë të gjatë kohore; produkti grumbullohet në qelizat e trupit dhe shkakton ndryshime dhe dëme nga të cilat nuk ka kthim mbarash.

SI VJEN HELMIMI

Nëse e gëlltisim: përmes gojës dhe traktit digjektiv. Kjo është rruga më e rrezikshme por jo shume e shpeshtë midis punetoreve bujqësore (1%). Rreziku i intoksikimit nga gëlltitje është i lehtë për tu parandaluar duke zbatuar rregullat elementare të higjienës dhe duke u sjelle në baze të rregullave (mos përdorë duhan, mos hani, etj).

Nga prekja: kur substanca helmuese thithet nëpërmjet lëkurës. Kjo është rruga më e përbashkët e intoksikimit (mbi 80%), sidomos kur nuk përdoren pajisje personale mbrojtëse (tuta, dorashka, çizme, etj).

Nepërmjet frymëmarrjes: përmes sistemit të frymëmarrjes. Është shumë e lehtë të mos jeni menjëherë të vetëdijshëm që jeni intoksikuar, veçanërisht kur substancat janë pa erë. Për të shmangur këtë lloj intoksikimi (rreth 19%) ju duhet të përdorni gjithmone pajisjet mbrojtëse personale DPI të duhura (maskat), duke verifikuar efikasitetin e filtrave që përdorni.


UDHËZIMET QË DUHET TË NDIQNI PËR PËRDORIMIN E PESTICIDEVE

Etiketa e produktit

Etiketa e pesticideve është një mjet kyç që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për të parandaluar rreziqet që lidhen me përdorimin e tyre.

- identifikimi dhe karakteristikat e produktit
- mënyra për trajtimin e duhur
- kohëzgjatja e efektit
- klasifikimi toksikologjik
- efektet e pa dëshiruara
- masat mbrojtëse që duhet të ndërmerren gjatë përdorimit
- masat për ndihmën e shpejtë
- mënyra për asgjësimin e shisheve

Leximi i etiketes me kujdes dhe respektimi i përpiktë i informacionit të përmbajtur është masa më efektive për të mbrojtur shëndetin e fermerit.



PESTICIDET

Është shumë e rëndësishme të njohim dhe të kuptojmë këto simbole.

Blerja dhe përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve që klasifikohen si "shumë toksike", "toksike" dhe "të dëmshme" është e lejuar vetëm për mbajtësit e autorizimit përkatës (patentino).

SIMBOLET E VJETRA TE RREZIKUT



SHPERTHYES



MERR FLAKE



MERR FLAKE



DIGJET



GERRYES



HELMUES



JASHTZAKONISHT
HELMUES



IRRITUES



I DEMSHEM



I REZIKSHEM
PER AMBJENTIN

JASHTZAKONISHT SHPEJT



SHPERTHYES



MERR FLAKE



DIGJET



GAS I NGJESHUR



GERRYES



HELMUES



HELMUES
AFATGJATE



IRRITUES



I DEMSHEM



I REZIKSHEM
PER AMBJENTIN

SIMBOLET E REJA TE RREZIKUT



PËRDORIMI I PESTICIDEVE

Përgatitja e pesticideve

- veshni paisjet mbrojtëse personale DPI
- mos pini duhan dhe mos hani gjate përgatitjes
- mos pini alkool para dhe pas përdorimit të pesticideve
- përgatitjen përzieje jashtë, në mungesë të erës
- në qoftë se ju duhet të peshoni produktin, përdorni një peshore ekskluzivisht për këtë qëllim; llogarisni sasinë e produktit në mënyrë që të shmangni mbetjet
- nëse produkti është në formë pluhuri, mbushni botin për gjysëm me ujë, shkrini vec me pak ujë produktin, hillenë atë brenda botit dhe vazhdoni ta mbushni me ujë duke e trazuar
- asnjëherë mos e mbushni botin deri në buzë për të parandaluar derdhjet
- **DOZIMI:** Sasia e përbërësit aktiv për hektar që do të shpërndani nuk ndryshon në bazë të volumit, sido që ta shpërndani atë me volum të lartë, të mesëm, apo të ulët !!!
- respekto gjithmonë udhëzimet e etiketës



it.wikipedia.org



Si të kryejm trajtimin

- vishni pajisjet mbrojtëse personale DPI
- vishni tuten, duke e mbajtur atë jashtë çizmes
- kontrolloni para përdorimit që maska tju rrijë në mënyrë të persosur me fytyrën
- kontrolloni skadenzen e filtrave edhe pse ende të pa përdorur
- filtrat në përdorim duhet të ndërroni çdo 6 muaj në qoftë se trajtojmë me raste, ose pas 40 orësh ose një javë në qoftë se trajtojmë shpesh
- filtrat në përdorim duhet të ndryshohen gjithsesi kur ndihet era e substancës
- kontrolloni nëse maska është e prishur ose nëse ka të gërvishura ose të çara
- mos trajtoni në qoftë se ka erë
- mos trajtoni në perjudhën e lulëzimit
- mos trajtoni afër shtëpive ose vendeve ku rrjeth ujë
- kryeni trajtimin me pesticide në orët me të fresketa të dites
- lajmëroni për trajtimin me pesticide duke vendosur në anë të fushës tabelë ku të shkruara qartë "Kujdes fushë e trajtuar me pesticide", të shoqëruar me shenjen e rezikut
- pas trajtimit, për një periudhë të caktuar kohore ("koha e rikthimit në fushë" - minimale 48 orë) mos hyni në fushë

Higjiena personale

- mbasi të keni mbaruar pastrimin e të gjitha pajisjeve që përdoret, mund të hiqni tuten dhe rrobat e punës duke pasur parasysh që dorashkat duhet të hiqen të fundit, në mënyrë që të mos preknin asgjë me duar të zhveshura
- lahuni me shumë kujdes me ujë dhe sapun dhe mundësisht beni dush mbas trajtimit me pesticide

PLUHURAT

PUNIMI I TOKES

Rreziku është më i madh në praninë e mbetjeve të produkteve të pesticideve të trajtimit paraprak mbi kulturat.

- reduktoni ngritjen e pluhurit duke punuar tokën kur kjo të jete në temperaturën e duhur (niveli i duhur i lagështise)
- punoni kur era fryn në mënyrë që reja e pluhurit nuk shkon mbi punëtorin
- përdorni traktore të pajisura me kabina
- mirëmbani dhe pastroni në mënyrë të vazhdueshme makineritë dhe pajisjet bujqësore

MBLEDHJA E MEKANIZUAR

Rreziqet mund të lindin nga:

- nga prezenca e pesticideve të mbetura nga trajtimet paraprake në kultura;
- nga tymi i prodhuar nga motorët me djegie të brendshme (traktorë, makineritë dhe pajisjet për mbledhjen, etj).
- nga pluhuri i tokës që ngrihet nga përdorimi i makinerive për mbledhjen (autokombanja, mbledhëse lajthishe, mbledhëse domatesh, etj).
- nga pluhurat me origjinë vegjetale (sidomos gjatë korrjes së drrithrave);
- nga përdorimi i produkteve hormonale (hormoni) për të nxitur pjekurinë dhe ngjyrosjen e prodhimit

Masat e parandalimit dhe mbrojtjes

- respekto GJITHMONË KOHEN E RIKTHIMIT NË FUSHE MBAS TRAJTIMIT ME PESTICIDE, dmth kohën që duhet të kalojë ndërmjet trajtimit të fundit me pesticide dhe mbledhjes së prodhimit.
- lexo me kujdes etiketat dhe të dhënat e sigurisë mbi të gjitha produktet kimike që përdorni
- përdorni makineri pune me djegie të brendshme të pajisur me dispozitivë shkarkimi të përshtatshme për karburantin e përdorur



PLEHERIMI

Rreziku vjen për shkak të manipulimit të plehrave kimike në format e tyre të ndryshme (të grimcuar, etj) dhe sidomos nga pluhuri që prodhohet gjatë shpërndarjes së tyre (plehra kimike në forme grimcash shpërndahen me shpërndarëse të plehut kimik të tipit "centrifugë")

Masat e parandalimit dhe mbrojtjes

- kryeni operacionet e pleherimit, duke punuar kur era fryn në mënyrë të tillë, që reja e pluhurit që ngrihet të mos mbulojë punëtorin
- respektoni GJITHMONË KOHEN E RIKTHIMIT NË FUSHE MBAS TRAJTIMIT ME PESTICIDE, dmth kohën që duhet të kalojë ndërmjet trajtimit të fundit dhe krasitjes, etj

RREZIKU KIMIKE GJATE AKTIVITETEVE TE TJERA

Mund te vije nga: tymi i prodhuar nga motorët me djegie të brendshme (kositëse bari, prerse bari, motorr sharre, etj) gjatë pastrimit te oborreve, argjinaturave, etj.
Pluhuri qe ngrihet nga pastrimi i dyqaneve, magazinave, kapanoneve, etj
vajrave lubrifikanti, karburante, vajit te djegur, solucjoni, tymi i saldimit gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit te makinerive dhe pajisjeve bujqësore, lyerja me boje, etj

TRETESIT

Përdoren në aktivitetet dytësore dhe per mirëmbajtjen.

Rreziku i helmimit:

- nga gelltitja e produktit
- nga thithja e avujve
- nga kontaktet

është në lidhje me faktorët e mëposhtëm:

- natyra kimike të substancës
- Sasia e perdorur
- gjendja fizike e substancës
- masat e marra gjate punes.

LUBRIFIKANTE

Rreziku është i lidhur me kontaktin e ketyre substancave, për shembull, gjatë mirëmbajtjes së automjeteve dhe pajisjeve.

Vajerat e djegur, përmbajnë sasi të moderuara të mbeturinave metalike qe mund te thithen me lehtësi nga lëkura, në rastin e kontaktit aksidental.

KARBURANTET

Rreziku kimike është i lidhur me mundësinë e thithjes se avujve te karburanteve.



Ajrosni lokalet gjatë pastrimit dhe kufizoni zhvillimin e pluhurit.

Përdorni makineri me motorr te pajisur me dispozitiv shkarkimi për karburantin e përdorur.

Lexoni me kujdes skedat e sigurisë dhe etiketat e të gjitha produkteve kimikateve të përdorura !!!

RREZIKU KIMIKE ZOTEKNIK

Në aktivitetet bujqësore, ushqimi, pastrimi, mjelja, etj, e kafshëve rreziqet kimike për punëtorët mund të identifikohen:

- në përdorimin e dezinfektantëve
- në përdorimin e pesticideve
- në përdorimin e detergjentëve
- shkaktuar nga pluhurat që mund të zhvillohet në keto aktivitete.

DEZINFEKTUES DHE DEZINFEKTANT

Janë përdorur gjatë dezinfektimit dhe disinfestacionit të mjediseve, pajisjeve dhe të kafshëve.



DETERGJENTET

Përdoren sidomos gjatë pastrimit të përditshëm në sistemin e mjeljes, veçanërisht për të hequr yndyrnat dhe substancat e tjera organike të qumështit, të cilat ngelen neper tubacione.

AVULLIM GAZESH

Krijohen kryesisht për shkak të mjedisit veçanërisht të ngrohtë dhe të lagësht që karakterizon ambjentin e brendshëm të stallave, të zonave të trajtura me pleh organik, vaskave që mbledhin ujërat e zeza, etj. Nga fermentimi i plehut organik, formohen gaze helmuese si sulfide hidrogjeni, amoniak, metan, dioksid karboni, etj.

PLUHURAT

Prodohen gjatë pastrimit të bagëtive dhe të stallave. Në pluhurin që ngrihet mund të jenë të pranishëm dezinfektues apo pesticide të përdorura më parë.

Lexoni me kujdes etiketën dhe skeden e produkteve të përdorura gjatë dezinfektimit dhe disinfestimit të mjediseve, pajisjeve dhe kafshëve.

PROGETTO "PUNTO INFORMATIVO CAMPO SICURO"



AGRI – SOLUTION:

Guida pratica per l'informazione dei rischi
specifici dell'agricoltura dedicato al
personale straniero operante nell'azienda
agricola

"RISCHI BIOLOGICI"

ALBANESE

In collaborazione con:

INAIL

ISTITUTO NAZIONALE PER L'ASSICURAZIONE
CONTRO GLI INFORTUNI SUL LAVORO

DIREZIONE REGIONALE
FRIULI VENEZIA GIULIA



Rreziku biologjik



RREZIKU BIOLOGJIK

Rreziku biologjik është mundësia që ka një punëtor për tu semurur nga infeksionet, alergjitë ose helmimi, që vijnë në kontakt me agjentët biologjikë (viruset, bakteret, kërpudhat ...) të pranishëm gjatë punës.

Kontakti me këto agjentë mund të vije ose drejtpërdrejt ose nepermjet qenieve të tjera të gjalla ("vektorëve"), si bagëtite lopet ose delet, derrat, insektet, etj

Në bujqësi, kontakti mund të vije në shumë raste.

Janë burime të mundshme rreziku:

- nga kontakti me tokën, me pluhura dhe ujë të ndotur
- nga plehërimi me plehra organike (bajga, pleh, etj)
- nga prania, në fushat e kultivimit të kërpudhave, sporet e kerpullave që mund të arrijnë përqendrime të larta
- prania e insekteve (mizave, mushkonja, pleshtave, etj)
- kontakti me kafshët e egra (qentë, dhelpër, minj, etj)



ÇFARË DUHET BËRË

- Vaksinimi kunder tetanosit (E DETYRUESHME!)
- Kujdesi i higjienës personale.
- Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse për tu mbrojtur sidomos gjatë pleherimit me material organik, ose gjate puneve qe ngrejne pluhur (tuta, dorashka, syze, maskë me filtër të tipit "P" dhe çizme).

RREZIQET NGA FAKTORËT BIOTIKË

Faktorët biotikë përfaqësojnë marrëdhëniet ndërmjet organizmave, si konkurrenca, grabitshmëria, simbioza, parazitizmi, etj

Rreziku biotik është i rregulluar nga titulli X i Dekretit Legjislativ nr. 81/08.

Merimangat e drurit

Mund të shkaktojë probleme të frymëmarrjes, asma bronkiale, rinitit alergjik (është një inflamacion kronik i mukozës së hundës), shqetësime.



Pleshtat

Mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme të tilla si morbin Lyme (infeksion i shkaktuar nga pickimi i pleshti) dhe Turbekulozin. Parandalimi konsiston në vaksinim kundër TBC në subjektet e ekspozuara dhe përdorimit të substancave për ti mbajtur larg.

CEFAP - INAIL



Gjitarë të vegjël

Pickim i gjitarëve të vegjël mund të shkaktojë sëmundje të ndryshme të tilla si tërbimit. Në zonat në rrezik janë të rekomanduara vaksinimet.



Zvarranikët

Efektet e kafshimit të zvarranikëve në Itali fillojnë nga shenjat e dhëmbëve në zonën e kafshimit, deri në situata më të rënda në të cilat manifestohen edema që i interesojnë pjesën e trrëngut dhe / ose shenja sistematike ose simptoma të rënda (hipertension të zgjatur, gjendje shoku, reagime alergjike, gjakderdhje)

Insektet

Shumica e pickimeve të insekteve mund të shkaktojë dhimbje, kuarje, djegie, ënjtje dhe efekte të tjera të lehta. Megjithatë për njerëzit shumë të ndjeshme mund të shfaqin efekte më të rënda dhe madje të rrezikshme për jetën.

RREZIKU BIOLOGJIK NE ZOTEKNI

Burimet kryesore të rrezikut në blegtori janë:

- Kontakti i drejtpërdrejtë me kafshët dhe derivate të saj (qumësht, bajga, sekrecione, etj).
- pastrimi i drejtpërdrejtë i bagëtive (larja, krehja, etj)
- heqja e mbeturinave dhe e bajgave, pastrimi i stallave, etj.
- gjate mjeljes ;
- gjate kujdesit dhe administrimit te terapive per kafshët e semura;
- nga prania e insekteve dhe parazitëve të kafshëve;
- nga kontakti me produktet e ushqimit per kafshet (pluhuri i kashtes, dritherat, etj);
- nga kontakti i drejtpërdrejtë me pajisje të ndotura.

ÇFARË DUHET BËRË

- Shmangni kontaktin me kafshët e infektuara ose me tokën e kontaminuar.
- Vaksinohuni nga tetanosi (E DETYRUESHME!).
- Mbani higjienën personale.
- Mbani paster kafshët dhe mjedisin ku punoni.
- Monitorimi i vazhdueshëm i shëndetit të kafshëve brenda fermës.
- Kontrolli i ushqimit që përdoret për ushqimin e kafshëve.
- Izolimi i kafshëve të sëmurë me masa urgjente.
- Mbrojtja e zonave të lira nëpërmjet kontrollit dhe mbikqyrjes të lëvizjes të kafshëve.
- Dezinfectimi i të gjitha materialeve (automjeteve, veshje, mjete ...).
- Shkatërrimi i kufomave, mbeturinave dhe produkteve të kafshëve të pranishme në zonën e infektuar.
- Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse për të parandaluar plage që mund të infektohen.
- Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse për tu mbrojtur gjatë kontaktit me kafshët e infektuara, gjatë pastrimit dhe dezinfectimit të stalles, etj (tuta, perparse, dorashka, syze, maskë fytyre me filter dhe çizme).



PROGETTO "PUNTO INFORMATIVO CAMPO SICURO"



AGRI – SOLUTION:

Guida pratica per l'informazione dei rischi
specifici dell'agricoltura dedicato al
personale straniero operante nell'azienda
agricola

"RISCHI ERGONOMICI"


ALBANESE

In collaborazione con:

Rreziqet “ergonomike”

ERGONOMIA

Ergonomia është shkenca që merret me bashkëveprimin e elementeve të një sistemi (njerëzore dhe te tjere) dhe funksionin për të cilin ata janë të krijuar, me qëllim që të rrisë kënaqësinë e përdoruesit, dhe përmirësimin e përgjithshme të sistemit . Në praktikë kjo është shkenca që merret me studimin e ndërveprimit në mes të njerëzve dhe të teknologjisë.



Fjalai "ergonomi" rrjedh nga fjalët greke Ergon (punë) dhe Nomos (sundimi i ligjit). Ajo është përdorur për herë të parë nga Wojciech Jastrzebowski në një gazetë polake në 1857 dhe u riperdor në 1949 nga Murrell, i cili ka përdorur atë për të përshkruar udhëzimet në projektimin e produkteve, shërbimeve dhe mjedisit që plotësojnë nevojat e përdoruesit.



ERGONOMIA:

SHKENCA E HARTIMIT TË PUNËS, PAJISJEVE DHE E VENDEVE TE PUNËS



Pozicjone pune Ergonomike ofrojnë mbështetje për mjedise-intensive pune. Termini Ergonomi përdoret në përgjithësi për të indikuar një ergonomi fizike që lidhet me

vendin e punës (të tilla si karrige komode ose të rehatshme dhe tastiera).

Ergonomia në vendin e punës ka të bëjë kryesisht me sigurinë e punëtorëve, mund të ndihmojë në uljen e kostove, përmirësimin e sigurisë, etj. Nëpërmjet ergonomisë, vendet e punës mund të projektohen në mënyrë që punëtorët nuk duhet të mbajnë pozicjonte të vështira të trupit.

Ergonometria preventive është procesi kërkimor i kushteve të punës që mund të përmirësohet dhe identifikimi i problemeve përpara se ato të bëhen probleme të mëdha. Problemet mund të zgjidhen paraprakisht nga përdorimi i pajisjeve të duhura, veprimtarisë ose projektimit të mjedisit.



LËVIZJA ME KRAHË E NGARKESAVE

Limiti i peshës që mund të ngrini në kushte ideale? (Mbrojtja për të paktën 90% të popullsisë së referencës))



Burrat (18-45 vjet): 25 kg

Gratë (18-45 vjet): 20 kg

Burrat (nën 18 ose mbi 45 vjet): 25 kg

Gratë (nën 18 ose mbi 45 vjet): 15 kg

- Kape ngarkesën me të dy duart, duke mbajtur kembet larg nejrës tjetres në një distancë rreth 20-30 cm.
- Ngrije atë gradualisht nga dysheja deri tek gjunjët dhe që këtu në pozitën e transportit.
- Gjatë ngritjes, mbaje shpinën drejt dhe asnjehere të perkulur përpara, krahët mbaj të ngurtë, këmbët mbaj të perthyera dhe drejtoji gjatë ngritjes.
- Gjatë transportit, nëse është e mundur, mbani ngarkesën të mbështetur mbi trupin, dhe shpërndaje peshën në të dy krahët.
- Nëse është e nevojshme (kur ngarkesa është e rëndë ose e madhe) mbajeni dy veta bashkë.
- Përdorni nëse është e mundur mjete për të ngritur dhe për të transportuar ngarkesat.

Transportimi dhe mbështetja e një ngarkese nga një ose më shumë punëtorë, duke përfshirë ngritjen, tërheqjen, shkarkimin, levizjen ose spostimin e një ngarkese, e cila nga natyra e saj mund të paraqesë një **rrezik lëndimi**, veçanërisht lëndim të shpinës.

Kjo mund të ndodhë nëse ngarkesa është **shumë e rëndë**, është e madhe apo e vështirë për tu kapur, nëse nuk është stabil dhe përmbajtja e saj mund të lëvizë, nëse ajo ka tehe të mprehta, në qoftë se ajo është shumë e nxehtë ose shumë e ftohtë, në qoftë se ajo përmban ndonjë material ose substancë të rrezikshme, në qoftë se ajo duhet të mbahet larg nga trupi.

Sforcoja fizike që kërkohet mund të jetë me pasoja nëse ajo zgjatet për një kohë të gjatë, në qoftë se ngarkesa levizet vetëm me rrotullimin e trupit, mund të rezultojë një lëvizje të papritur e ngarkesës, në qoftë se ngritja është bërë me trupin në një pozicion të paqëndrueshëm, në qoftë se ngritja e peshave është shumë e shpeshtë ose për një kohë të zgjatë.

LEVIZJET E PERSERITURA TE GJYMTYRËVE TE SIPËRM

Mund të sjellin sëmundjet te muskujve dhe te skeletit

- Bëni pushime gjate punës ose, nëse është e mundur, alternoni punë të ndryshme (mos ekspozoni krahët ndaj dridhjeve) për të lejuar një pushim të mjaftueshëm të gjymtyrëve të sipërme (të paktën 10 minuta cdo orë).
- Kapi produktet që do të transportosh fort, por shtrëngoje vetëm me forcen e duhur (mos u sforco më shumë se sa është e nevojshme).
- Në rast të shiritave të transportimit thjesht lereni produktet të bijen në tokë ose në enët e posacme, prodhimet që do të eliminoni mos i shoqëroni me dorë, dhe mos i hidhni, por thjesht leshojn, duke hapur pak gishtat e dorës.
- Nëse është e mundur alternoni të dyja duart gjate punës.
- Bëni ushtrime me gishtat gjatë kohës së pushimeve.
- Mundohuni të mbani një pozicion që tju lejojë të reduktojë sa më shumë të jetë e mundur lëvizjet e bërrylit dhe të pulsit.



GJESTET E PERSERITURA GJATE MJELJES

- Gjate mjeljes manuale kapini gjinjtë e lopes fort, duke i shternguar vetëm sa është e nevojshme për rrjedhjen e qumështit (mos forzoni duart më shumë sesa është e nevojshme).
- Gjate mjeljes mekanike mbajeni makinerinë fort, duke e shternguar vetëm sa është e nevojshme për ta afruar atë tek gjinjtë e lopes (mos forzoni duart më shumë sesa është e nevojshme).
- Nëse është e mundur alternoni duart gjate mjeljes.
- Bëni ushtrime me gishtat gjatë pushimeve.
- Mundohuni të marrë një pozicion që të reduktojë sa më shumë të jetë e mundur lëvizjet e bërrylit dhe të pulsit.

POZICIONI I TRUPI, MBAJTUR PER NJE KOHE TE GJATE

Mund të shkaktojnë sëmundje të muskujve dhe të skeletit

- Beni pushime gjate punes dhe, nëse është e mundur, alternoni punë të ndryshme (qe te mos ekspozojne trupin ndaj drridhjeve) ne menyre qe trupi te shplodhet (të paktën 10 minuta per cdo orë).
- Gjatë pushimeve uluni (në qoftë se punoni në këmbë), ose qëndroni ne kembe (në qoftë se punoni ulur); madje hecni pak.
- Nëse punoni në këmbë, gjate punes, ngrini kembet duke i alternuar ato nje here njerën dhe pastaj tjerën, mbeshtesni kemben ne një mbështetje të përshtatshëm dhe mbajeni ne këtë pozicion deri sa te shfaqen shenjat e para të lodhjes.
- Ndryshoni shpesh pozicion gjate punes, kur eshte e mundur.
- Sigurohuni se ka hapësirë për këmbët (nese punoni në këmbë ose nese punoni ulur) në vendin e punës qe trupi te mos marre pozicion të vështirë (dmth me trupin pak të përkulur përpara).



RREZIQET "RRETHANORE" NGA ORGANIZIMI I PUNES

Janë quajtur "Rreziqet e ndërlidhura", ato rreziqe që lindin nga marrëdhëniet komplekse që krijohen në mes të punëtorëve të ndryshme, midis punëtorit dhe detyrës së tij të veçantë, midis punonjësit dhe ambientit në të cilin ai është i detyruar të punojë. Të gjitha këto ndërveprime janë shkaqe të mundshme të stresit dhe të rendimentit të dobët të punëtorit, që shpesh, për një kohë të gjatë, mund të sjellë në një gjendje pakujdesshmerije me pasoja serioze për sigurinë dhe shëndetin.

Ndër burimet kryesore të stresit në ngarkim të punëtorëve agrarë mund të kujtojmë:

- puna e vazhdueshme
- puna gjatë natës
- levizja manuale e ngarkesave
- DPI jo komfort
- intensiteti, monotonia, vetmia
- nevoja e domosdoshme e njohurive dhe e aftësive të stafit.

Turne të gjatë, pa pushim, duke punuar edhe të shtunave dhe të dielave, do të përcaktojë një situatë të rrezikshme me rritjen relative në rrezikun e aksidenteve.

Mundohuni të përmirësoni kushtet e ambientit të punës dhe të shmangni punën natën (kur është e mundur).


Në rast se punoni natën pushoni në mënyrë të mjaftueshme gjatë ditës.

Përdorni vetëm DPI të nevojshme, ruajini dhe përdorni DPI në mënyrën e duhur.

Mundohuni të alternoni punët, në mënyrë që të bëni punë të ndryshme gjatë ditës (nëse është e mundur).

Bëni pushimet e nevojshme gjatë punës, në marrëveshje me punëdhënësin.

Mundohuni të krijoni një atmosferë miqësie dhe qetësie me kolegët.



PROGETTO "PUNTO INFORMATIVO CAMPO SICURO"



AGRI – SOLUTION:

Guida pratica per l'informazione dei rischi
specifici dell'agricoltura dedicato al
personale straniero operante nell'azienda
agricola

"DPI"

ALBANESE

In collaborazione con:

Paisjet Mbrojtese Personale

PAISJET MBROJTESE PERSONALE (DPI)

1

Kur duhen përdorur?

Vetëm në rast kur ju nuk mund të eliminoni rrezikun.

Degjoni punëdhënësit tuaj!

2

Cilat janë kriteret për zgjedhjen?

I DPI zgjedhen sipas dy kriterëve kryesore:

- *Ne varësi te pjesës se trupit që duhet mbrojtur;*
- *Në varësi të llojit dhe shkallës së rrezikut specifik.*

4

Kur janë në përputhje me ligjin?

Kur ju keni një numër të kërkesave teknike të parashtruara më poshtë:

- duhet të jetë te përshtatshme për te parandaluar rreziqet dhe pasojat e tyre pa paraqitur një rrezik më të lartë;
- duhet të përshtaten me kushtet ekzistuese te vendit te punës;
- duhet të përmbushin nevojat ergonomike dhe te sigurojne shëndetin e punëtorit;
- duhet te përshtaten për tu përdorur sipas nevojave;
- duhet të plotesojne kërkesat thelbësore të sigurisë, qe do te thote, që duhet te jene në përputhje me standardet e Dekretit Legjislativ 4 dhjetor 1992 n. 475 (CE) dhe te modifikimeve te mëvonshme.

3

Si klasifikohen?

1. Kategorja e pare - rrezik i lehte - i vetë-certifikuar nga prodhuesi.
2. Kategorja e dyte - rrezik i madh - kur pjeset ne rrezik jane per shembull sytë, duart, krahët, fytyra - materjalet mbrojtese duhet te jene të vërtetuara nga nje organ inspektues kompetent i autorizuar dhe i njohur nga organet kompetente.
3. Kategorja e trete - rrezik shume i lartë - përfshin të gjitha mjetet e mbrojtjes personale DPI per frymëmarrjen dhe per mbrojtjen nga rreziqet vdekjeprurëse.



KLASIFIKIMI I PAISJEVE MBROJTESE PERSONALE (DPI) SIPAS ZONËS SË TRUPIT QË DUHET TE MBROJME

KUR?

Mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes



Mbrojne rruget e frymëmarrjes nga substancave të dëmshme (gazrat, pluhurat, avujt) dhe sigurojnë një frymëmarrje normale. Në përgjithësi janë maska që mbulojnë komplet fytyrën, maska që mbulojnë vetëm gojen dhe hundën, që ndryshe quajmë gjysëm maska, maska kundër pluhurit dhe aparate për frymëmarrjen.

Vini Re: në mjedise të izoluar mund të kenë nevojë për të përdorur bombola ajri për frymëmarrjen: pyesni punëdhënësit tuaj !!!

Gjate trajtimit, sterilizimit dhe pastrimit të mjediseve me lëvizje të kufizuar (kapanoneve, cisterna, etj).

Mbrojtja e syve



Përfaqësohen nga syze mbrojtëse, maska që mbulojnë sytë, maska që mbulojnë komplet fytyrën, janë të dobishme kundër spicave që mund të hyjnë në sy, materialeve të nxehta ose kaustike, ose materialeve gërryese.

Gjate punëve mekanike, dhe gjate përdorimit të sharrave elektrike ose motorr sharrave, gjate krasitjes dhe mbledhjes së ullinjëve dhe pemëve të ngjashme, si dhe pastrimi i zonave rurale me prerese bari (dicipuljatore).

Mbrojtja e dëgjimit



Janë të nevojshme kur ju nuk mund të zvogëloni zhurmën nën 85 dB (A) të përditshme mesatarisht. Mund të përdoren kufjet kundër zhurmave (mund të kombinohet me helmetë pune të pajisur me radio), ose tapa për veshet të lidhura me një zinxhir, dhe harqe.

Eshtë e ndaluar përdorimi i kufjeve kur jeni duke ngare mjetet në rrugët publike!

Kur jeni duke ngare traktorët bujqësorë pa gabine, traktorët me zinxhire, dhe gjate punës me motorr sharre dhe prerese bari, etj.

KLASIFIKIMI I PAISJEVE MBROJTESE PERSONALE (DPI) SIPAS ZONËS SË TRUPIT QË DUHET TE MBROJME.

Mbrojtja e gjymtyrëve të sipërme



Mbrojtja e gjymtyrëve të sipërme është e garantuar nga llojet e ndryshme të paisjeve mbrojtëse personale DPI: dorashka (të cilat mbrojnë nga rreziku mekanik, elektrike, elektrostatische, kimike, biologjike, nga të ftohtë, nga të ngrohtë dhe nga dridhjet), **palmare te sigurise** dhe mengore ose dorashka deri te berrylat. Dorashkat mund të jenë të materialeve të ndryshme të tilla si plastike, gome, lëkurë dhe materiale dielektrike (izolim elektrik).

Nevojiten për të mbrojtur këmbët duke ruajtur sigurinë dhe garantojnë stabilitetin e mirë të punëtorit. Përfshijnë: këpucë, mbrojtëse gjunjesh, mbrojtëse për kercirin e kembes, kepuce ku thembra mund të lëvizë lirshëm, mbrojtëse të lëvizshme për kycin e kembes. Kepucet e pershtatshme në punë me rrezik të lartë (kantjeret e ndërtimit, kantjeret në rrugë, ofcinat mekanike, ofcinat metalurgjike, etj) duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme: stabilitet të mirë, të zberthehen lehtë, maja e kepuces duhet të jete rezistente ndaj perplasjeve, sholli duhet të jete rezistent dhe të mos shpohet lehtë dhe të mos jete i rreshkitshem, duhet të mbrojnë kembet nga i nxehti dhe nga i ftohti, mbrojtëse të buta për thembrat, mbrojtëse të buta për kycet e kembes, mbrojtjes kundër kërpudhave dhe mykut të kembeve dhe mbrojtjen ndaj ngarkesave elektrostatische.

Mbrojtja e gjymtyrëve të poshtme



KUR?

Gjate puneve të tipit mekaniko bujqësor gjate punes me pleh organik, gjate kujdesjes për shëndetin dhe higjienen e kafshëve. Ne të gjitha hapat që lidhen me përdorimin e pesticideve, plehrave kimike ose organike.

Gjate të gjitha puneve të tipit mekaniko – bujqësor, kur ngisni makineritë bujqësore, gjate të gjitha puneve që kryeni në fushë apo në serre.

KLASIFIKIMI I PAISJEVE MBROJTESE PERSONALE (DPI) SIPAS ZONËS SË TRUPIT QË DUHET TE MBROJME.

KUR?

Mbrojtja e trupit dhe e lëkurës



Për të mbrojtur trupin paisjet mbrojtëse personale DPI janë të shumëfishta: veshje mbrojtëse (kundër rreziqeve mekanike, kimike, biologjike, kunder nxehtesise, kunder rrezatimit, etj), paisje mbrojtëse per trungun dhe per barkun (xhaketa apo perparese) dhe paisjet mbrojtëse per lëkuren (krem mbrojtës, pomade).

Gjate punes ne fushe, gjate punes neper qelite frigoriferike, dhe gjate punes qe përfshin ekspozimin ndaj pluhurave, tymit ose avujve dhe bigorit me yndyrë, të cilat ekspozojnë drejtpërdrejt trupin me substancave ose pergatitje të rrezikshme si toksike, të dëmshme, korrozive ose irrituese. (pleherimi i tokes, kujdesi per kafshët, etj.).

Mbrojtja e kokës



Helmete pune / përkrenare, qe përbëhet nga pjesët e mëposhtme: rripa sigurimi qe mund ta lidhim helmeten nen mkeker dhe mbulese mbrojtëse kunder djerses, ajo duhet të përmbushë kërkesat e rezistencës te mjaftueshme dhe te mos shpohet lehte, duhet te jete rezistente ndaj goditjeve dhe duhet te lejoje nje ajrim të mirë te kokes. Helmeta (ose përkrenare) duhet të jetë në përputhje me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale DPI te tjera si kufje ose vizjere dhe duhet të jetë e rregullueshme në lartësi dhe gjerësi.

Puna në lartësi, mbi fuci ose vaska , në punen per mirëmbajtjen e gjelbër, gjate levizjes së ngarkesave nga lart.

KLASIFIKIMI I PAISJEVE MBROJTESE PERSONALE (DPI) SIPAS ZONËS SË TRUPIT QË DUHET TE MBROJME.

KUR?

Mbrojtja nga rreziku i renjes nga lartësite



Bejne pjese në kategorinë e trete, sepse rreziqet e rënies nga lart mund tju shkaktojë dëmtime të rënda fizike punëtorëve; prandaj janë subjekt i procedurave të veçanta të certifikimit. Këto pajisje mbrojtese personale DPI janë: rripa sigurimi, dhe rripa sigurimi te pajisur me nje litar qe mund te fiksohet ne nje vend stabel. Pajisje mbrojtese personale DPI janë të nevojshme jo vetëm në prani të rrezikut të renjes nga lart, por edhe për punëtorët të cilët veprojnë brenda puseve dhe/ose cisternave. Pika ku fiksohet rripi i sigurimit duhet të jetë vendosur në mënyrë që të sigurojë efektivitetin e një sistemi për mbrojtjen nga rënja dhe bie nën juridiksionin e përdoruesit.

Gjate punes në lartësi (më e madhe se 2 m), punes mbi pjataforma ajrore, mirëmbajtjes se kapanoneve dhe cisternave.

Mbrojtja nga përplasjet Punëtorët që punojnë në kantjeret e ndërtimit apo sheshe, neper rrugë, neper hekurudhat, aeroportet apo vendet e punës ku shikimi eshte i kufizuar, janë të detyruar qe të përdorin "veshje fosforeshente qe dallohen nga larg" si gjate ditës ashtu dhe gjate natës. Përdorimi i pajisjeve mbrojtese personale DPI fosforeshente i bën më të dukshem këta punëtorë duke kufizuar rrezikun e perplasjeve.



Gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve dhe makinave bujqësore, kur jeni duke ngare makineri bujqësore mbi rrugët publike, gjate mirëmbajtjes te zonave të gjelbra marginale dhe mirëmbajtjen e gjelbër urbane.

PUNEDHENESI

Eshte i detyruar: të verë në dispozicion të punëtorëve, sipas normave të higjenës ne pune, pajisjet e përshtatshme per mbrojtjen personale; ti ruajne ato në kushte të përkryera higjienike dhe te jene gati për përdorim.


PERGJEGJESI PER PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN

Ka detyrimin për tju dhënë informacione punëtorëve mbi pajisjet mbrojtëse personale qe duhet te perdorin

Eshtë i detyruar të përdori pajisjet mbrojtëse personale. DPI vetëm për qëllimin e synuar, eshte i detyruar te kujdeset për ato, nuk duhet te beje ndryshime dhe duhet të raportojë çdo difekt apo problem specifike; për disa lloje të pajisjeve personale mbrojtëse punetori është i detyruar që t'i nënshtrohet programeve të trajnimit qe te mesoje perdorimin e tyre.

PËRFAQËSUESI I PUNËTORËVE PËR SIGURINE

Përfaqësuesi i Punëtorëve per Sigurine (RLS) merr pjesë në përzgjedhjen e Pajisjeve Personale Mbrojtëse.



PROGETTO "PUNTO INFORMATIVO CAMPO SICURO"



AGRI – SOLUTION:

Guida pratica per l'informazione dei rischi
specifici dell'agricoltura dedicato al
personale straniero operante nell'azienda
agricola

"SEGNALETICA" ALBANESE

In collaborazione con:

Sinjalet e sigurise


SINJALET E SIGURISE: FORMAT DHE NGJYRAT

Shenjat e ndalimi




Kane formë të rrumbullakët, figure të zeza mbi një sfond të bardhë; ane te kuqe

Shenjat e detyrueshme



Kane formë të rrumbullakët, figure të bardhë në një sfond blu

Shenjat paralajmëruese




Kane formë trekëndëshe, figure të zeza mbi një sfond të verdhë me ane të zeza

Shenjat e shpëtimit



Kane forme katrore ose drejtkëndëshe, figure të bardhë mbi një sfond jeshil.

Shenjat e pajisjeve të zjarrit



Kane forme katrore ose drejtkëndëshe, figure të bardhë mbi një sfond të kuq

SHENJAT E NDALIMIT



Ndalim kalimi



Ndalohet Duhanpirja
Ndalohet pirja e duhanit
dhe
përdorimi i flakës



Mos e shuaj zjarrin
me ujë



Uji jo i pishem



Mos prek



Ndalohet hyrja personave
të paautorizuar



Ndalohen rimorkjot ne
levizje



Mbrojtje e detyrueshme
e rrugeve te
frymëmarrjes



Këpucë te
sigurise te
detyrueshme



Dorashka mbrojtëse
të detyrueshme



Mbrojtje e
detyrueshme e trupit



Mbrojtje e
detyrueshme e
fytyrës



Mbrojtje personale e
nevojshme kundër
renjes



Mbrojtje e nevojshme
e syve



Helmetë sigurie e
detyrueshme



Mbrojtje e
detyrueshme e
degjimit



Kujdes



Kalim i detyrueshëm
për këmbësorët

SHENJAT PARALAJMËRUESE



Material që ndizet
lehte ose me
temperaturë të
lartë



Material eksploziv



Substanca helmuese



Substanca korrozive



Substanca të dëmshme
apo irrituese



Ngarkesa pezulluar



Tension elektrik



Kujdes



Material i djegshëm



Mjete në levjzje



Rrezik pengimi



Rezim nga diznivele



Rrezatimi jo-
jonizues



Temperaturë e ulët



Rrezik biologjik

SHENJAT E SHPËTIMIT



Rruga/ Dalja e urgjencës



Ndiq drejtimin



Ndihma e
shpejtë



Barelë



Dush Sigurie




Laj syte



Telefoni për shpëtim
dhe ndihmën e parë

SHENJAT E ZJARRIT



Tub për lokalizimin e zjarreve





Shkalle



Bombul zjarrfikëse



Telefon për
luftimin e zjarrit



Drejtimi për tu ndjekur

(Tabele qe ju shtohet tabelave te mesiperme)

SINJALIZIMI ME GESTE

Start, Kujdes, prizë e komandës



NDAL, ndërprerje, mos lëvis



FUND i veprimeve



Lëvizjet vertikale

NGRIJE



ULE



DISTANCA VERTIKALE



Levizjet horizontale


PERPARA



MBRAPA



DJATHTAS me sinjalizues



MAJTAS me sinjalizues



DREJTIM HORIZONTAL



Rrezik

RREZIK STOP ose ndalim urgjent



LEVIZJE E SHPEJTE

Gjestet konvencionale të përdorura për të treguar që lëvizjet janë kryer më shpejt

LEVIZJE E NGADALTE

Gjestet konvencionale të përdorura për të treguar që lëvizjet janë kryer më ngadale

SINJALIZIM VERBAL

"via"	Për të treguar se ka filluar operacioni.
"alt"	Për të ndaluar ose për të përfunduar një lëvizje.
"ferma"	Për të ndaluar operacionet.
"solleva"	Për të ngjitur një peshë.
"abbassa"	Për të zbritur një peshë.
"avanti" "indietro" "a destra" "a sinistra"	(Nëse është e nevojshme, këto urdhëra duhet të koordinohen me sinjalet përkatëse të dorës)
"attenzione"	Për të urdhëruar një stop ose një ndalesë urgjente.
"presto"	Për të përshpejtuar një lëvizje për arsye sigurie.